



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kryetari i Komunës

Nr. 01/\_\_\_

Datë; 14/04/2015

Mbështetur në nenin 12 par. 12.2 shkronja ( c dhe d ), neni 13, 17 shkronja ( h ) 24 dhe neni 58 ( shkronja b dhe d ) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ( Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës nr.02/352, dt.30.09.2014,

*Kryetari i Komunës me datë 14 .04. 2015 mori vendim për ;*

### **SHPALLJEN E KONKURSIT**

#### **PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTET E KOMUNËS SË MALISHEVËS PËR VITIN AKADEMIK 2015.**

Të gjithë studentët/et e rregullt,të komunës së Malishevës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultetet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentet në studime Pasuniversitare-Mastar dhe Doktorantë,kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave-subvencioneve për studime të rregullta.

Për këtë qëllim,komuna e Malishevës do të ndajë gjithsej pesëdhjetë ( 50 ) bursa në vlerë prej pesëdhjetë euro( 50 €), për një muaj, dhe e njëjta do të ndahet për muajt ( Janar -Qershor ).

#### **Kriteret e përgjithshme për të fituar bursën-subvencionin nga komuna e Malishevës :**

- Studentët që studiojnë në Universitetet Publike,
- Shfrytëzues të bursave mund të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Malishevës,
- Studentët te cilët janë dy ( 2 ) e më tepër nga e njëjta familje,
- Shfrytëzues të bursës studentore mund të jenë vetëm studentët rregullt,
- Nuk do të ketë më shumë se dy bursa për profile të njëjta,
- Studentët që janë shfrytëzues të bursës Universitare apo ndonjë burse tjetër nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të kësaj burse,
- Studentët që janë në marrëdhënie pune nuk mund të jenë përfitues të bursës,
- Prioritet kanë studentët e familjeve të dëshmorëve,invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së, me gjendje të rëndë ekonomike si dhe rastet sociale, të cilat duhet të vërtetohen me dokumentacion përkatës!

**Dokumentet e nevojshme për aplikim :**

- Certifikata e notave (originale),
- Kopja e indeksit me të gjitha provimet e dhëna,
- Kopja e letërnjoftimit,
- Vërtetimi se aplikuesi është fëmijë i dëshmorit,
- Për rastet sociale, vendimi mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2015,
- Vërtetimi se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2015 ( i rregullt).

**Vërejtje :** Bursat do të ndahen vetëm për studentë që kanë mbaruar një vit e më shumë të studimeve. Bursat ndahen për afatin kohor retroaktiv : **01.01.2015** deri më **30.06.2015** ( për gjashtë muaj).

- a. Përfshirja e të gjitha profileve, nga secili profil nga një student,
- b. Përfitues do të jenë ata studentë me mesataren më të lartë në konkurrencë brenda një profili,
- c. Te studentët e një profili me kushte të barabarta do të merret për bazë mesatarja më e lartë e notave profesionale.

**Konkursi mbetet i hapur për aplikim deri më datë,28.04.2015, (14 ditë kalendarike ) duke filluar nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve të KK-së.**

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara duhet të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve ne Malishevë ( objekti i ri i administratës) .

Të gjitha kërkesat e parashtruara do të shqyrtohen nga komisioni përkatës.

Malishevë,2015

Kryetari i Komunës  
Ragip Begaj

---